

DPK/DMP

03-1551/13

02

27-05-2013

Shifra,0599,RI.nr.11536/2012

GJYKATA THEMELORE,DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE –FERIZAJ,në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Hesat Shatrolli nga fsh.Pleshinë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 17.1.1 të ligjit për deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lart publikë dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr.04/L-050,e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet,më 26.04.2013,muarr këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri Hesat Nuhi Shatrolli,i lindur me dt.10.02.1964 në fsh.Pleshinë K Ferizaj,ku dhe tani jeton , me profesion mjek.

ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

sepse deri me dtë 31.03.2012 nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë së tij,edhe pse ka qenë i obliguar në bazë të ligjit që ta bëj një deklarim të tillë, ngase ushtron funksionin publik si këshilltar i asambles komunale të komunës së Ferizajt .

-me çka ka bërë vepër kundërvajtëse nga neni 17.1.1 të ligjit për deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lart publikë dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr.04/L-050

-andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, e në vështrim të nenit 9 të LK-së

D E N O H E T

ME DENIM NË TË HOLLA,në shumën prej 300 € (treqind euro).

Denimin e shqipëtuor në të holla ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi,në të kundërtën denimi i tillë në të holla do ti zëvendësohet me denim burgu në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 5 €,në afatin e njëjtë sikurse edhe denimin në të holla,nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Nga një ekzemplarë i aktvendimit u dërgohet palëve.

A r s y e t i m

Agjencia kundër korrupsionit e Republikës së Kosovës,ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse me nr 01-2209/2012 të dt.04.06.2012, kundër të pandehurit për shkak të kundërvajtjes për mos deklarim të pasurisë me kërkesë të agjencisë të zyrtarit të lartë publik dhe për këtë ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të nenit 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lart publikë dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr.04/L-050.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, muarr në pyetje të pandehurin,i cili ka theksuar se që nga viti 2007 jam anëtar i KK të Ferizajt dhe vazhdimisht nga ky vit kam bërë deklarimin e pasurisë sime pranë AKK në Prishtinë dhe formularët për deklarim të pasurisë i kam marrë nga organet partiake kur këtë kam qenë i obliguar ta bëj në bazë të tyre ,ndërsa herat tjera formularin e kam marrë nga zyrtari komunal dhe pasi e kam plotësuar ua kam dërguar të njëjtëve nga të cilët e kam marrë formularin dhe asnjëherë nuk kam pasur problem,ndërsa në këtë viti -2012, formularin e kam marrë nga Afrim Matoshi –zyrtar komunal dhe pasi e kam plotësuar ate së bashku me të,ia kam dorëzuar të njëjtit që ai ta dorëzoj tek personat që janë kompetent për ta dërguar këtë formular në AKK në Prishtinë,dhe me këtë veprim unë kam menduar se e kam kryer obligimin tim dhe më vonë kur kam marrë ftesë nga gjykata për këtë çështje unë kam shkuar në AKK në Prishtinë për të kërkuar sqarimin rreth formularit tim për deklarim të pasurisë mirëpo aty e kam kuptuar se i njëjti fare nuk kishte arritur atje dhe pas këtij momenti kam bërë deklarimin e pasurisë tek ky organ që si dëshmi për këtë po ua prezantoj vërtetimin e tyre të dt.10.09.2012.Ndërsa sa i përket Naser Musës që qenka person kontaktues në mes AKK në Prishtinë dhe zyrtarëve të lartë të komunës së Ferizajt,unë mund të them se këtë person as që po

Për vërtetim të gjendjes faktike në mënyrë sa më të plotë dhe reale gjyqtari ka marrë në pyetje Naser Musën –zyrtar i pikës kontaktuese për ndërlidhjen e punëve me AKK të Kosovës pranë Kuvendit komunal në Ferizaj, Afrim Matoshin –shef i protokolit në komunën e Ferizajt, Agron Behramin –shef i divizionit për deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik pranë AKK në Prishtinë ,si dhe ka bërë ballafaqimin e të pandehurit me Afrim Matoshin, dëshmitari Naser Musa në dëshminë e tij ka theksuar se materialet bashkë me formularët të cilët i ka pranuar nga AKK ju ka shpërnda këshilltarëve komunal të komunës në mbledhjen e KK të Ferizajt të dt.09.03.2012,si dhe nga foltorja e kuvendit janë njoftuar për këtë çështje gojarisht nga kryesuesi i asamblesë në atë kohë tani kryetar i komunës Agim Aliu,për qka dhe gjykatës i prezantoi regjistrin e anëtarëve pjesmarrës dhe nga ky regjistër shifet se i pandehuri Hesat ka qenë pjesmarrës në mbledhje dhe e ka pranuar formularin për deklarim të pasurisë .Ndërsa Afrim Matoshi deklaroi se të gjithë këshilltarëve komunal të Ferizajt në mbledhjen e dt.09.03.2012 u kam lënë në ulset e tyre formularët për deklarim të pasurisë pranë AKK dhe kryesuesi i asamblesë nga foltorja u ka kërkuar të gjithë këshilltarëve komunal ti mbushin formularët dhe pa vonesë ti dorëzojnë në AKK në Prishtinë dhe në këtë mbledhje përveq tjerëve ka qenë prezent edhe Hesati siq shifet nga lista e pjesmarrëve në këtë mbledhje,ndërsa nuk qëndron ajo që ka deklaruar ai se mua ma ka dhënë formularin e plotësuar për deklarim të pasurisë së tij ,pasi që kjo as që ka qenë detyrë e imja ,ndërsa A.Behrami tha se ne si Agjencion këshilltarëve të asambleve komunale u kemi kërkuar përmes zyrtarëve tonë kontaktues në komuna që të njoftojnë zyrtarët e tyre të lartë publik që të bëjnë deklarimin e pasurisë dhe për komunë të Ferizajt për këtë çështje kemi pasur personin Naser Musa dhe i njëjti na ka njoftuar se të gjithë zyrtarëve publik të komunës u ka dorëzuar formularët dhe i ka njoftuar ata që ti plotësojnë formularët,ndërsa ndonjë kërkesë të veçantë këshilltarëve të asambleve komunale të komunës së Ferizajt nuk u kemi bërë.Ndërsa në seancë të ballafaqimit dëshmitari A.Matoshi duke e shikuar në sy të pandehurin Hesat i tha se nuk është e vërtetë që me dt.09.03.2012 kur është mbajtur mbledhja e asambles komunale që unë të kam ndihmuar për me plotësu formularin për deklarim të pasurisë dhe që ma ke dorëzuar ate,kurse i pandehuri në këtë rast pranoi se nga ai ka pranuar formularin e AKK për deklarim të pasurisë ,dhe iu drejtua Afrimit se formularin e kam plotësuar gjatë mbledhjes me ndihmën tënde dhe pasi kam plotësuar ate të thash se po e le në ulësen time dhe me këtë kam menduar se e kam kryer obligimin tim ligjor për këtë çështje , ndoshta ka qenë një mosmarrveshje në mes nesh por kjo që po them ka qenë kështu.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, deklaratës së të pandehurit, të dëshmitarëve ,ballafaqimit të kryer,e shkresave tjera të lëndës,gjyqtari konstatoi se i pandehuri me veprimet e tija ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 17.1.1 të të ligjit për deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr.04/L-050 ,e jo siq është ngarkuar në kërkesë në bazë të nenit 17.1.3 të ligjit në fjalë,dhe për këtë bëri rikualifikimin e veprës kundërvajtëse dhe të pandehurin shpalli përgjegjës dhe dënoi siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjatë matjes së denimit është marrë parasysh pesha e kundërvajtjes dhe pasojat e saja , rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendja ekonomike e të pandehurit,si dhe fakti se i pandehuri ka bërë deklarimin e pasurisë më vonë që dëshmohet në bazë të vërtetimit të lëshuar nga AKK të dt.10.09.2012 ,se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin ,andaj dhe duke u bazuar në këto rrethana të përmendura më lartë ,në vështrim të nenit 9 të LK-së ,ju kërkohet të denimit dhe ju shqiptua një denim i tillë në të holla i cili është nën minimumin paraparë ligjor me bindje se edhe me këtë lloj denimi do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Sekretarja juridike

Kimete Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit, Departamentin e përgjithshëm të Divizionin për kundërvajtje në Prishtinë,mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës kundër pandehuri në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes të kësaj Gjykate, pa pagesë takse.

